



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2025

Shtojca 14.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

Data 24/04/2025

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE)

X ose

"DRINI A" Shpk, me Nuis J67902505V dhe me adrese Lagjja "Nen Tereza", godina ne rrugen nacionale Lezhe - Shkoder km I, ne zonen kadastrale 8632, me nr. pasurie 13/55-1, volum 24, faqe 225, Lezhe.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur, mbi kufirin e larte monetar.

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: REF-38895-02-21-2025.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Blerje materiale per mirembajtjen e rrugeve, trotuareve, shesheve, sistemit ujites dhe kullues ne Bashkine Lezhe".

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj nga data e nenshkrimit te Marreveshjes Kuader.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: Date 10/04/2025.

¹Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini Nr. 18, datë 14 Prill 2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

- 1- Operatori Ekonomik "DRINI A" Shpk, me Nuis J67902505V, me oferte ekonomike 39,485,595 (tridhjetë e nente milion e katerqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e nentëdhjetë e pesë) Lek pa TVSH,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

- 2- Operatori Ekonomik "M U R A T I" Shpk, me Nuis J66702413V, me oferte ekonomike 39,880,430 (tridhjetë e nente milion e teteqind e tetëdhjetë mijë e katerqind e tridhjetë leke) Lek pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

- 3- Operatori Ekonomik "ORNIAD" Shpk me Nuis J68423509H, me oferte ekonomike 41,307,287.35 (dyzet e një milion e treqind e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë pike tridhjetë e pesë) Lek pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I. Operatori Ekonomik "ORNIAD" SH.P.K, me Nuis J68423509H,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE:

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.2.1 dhe 2.2.2, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se: “2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi.

2.2.2 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

KVO verën se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimin e xhiros dhe bilancet për vitet financiare 2021,2022,2023 sipas kërkesës së pikës 2.2.1 dhe 2.2.2 të DST-se.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për xhiron vjetore apo bilancë duke mos përmbushur këto kriter.

Se, dyti nuk ploteson kriterin 2.3.1, deri në kriterin 2.3.7, te kushteve te veçanta te kualifikimit, pasi nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në përmbushje të këtyre kriterëve.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh

me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “ORNIAD” SH.P.K, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ORNIAD” SH.P.K, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

- 1- Operatori Ekonomik "DRINI A" Shpk, me Nuis J67902505V, me oferte ekonomike 39,485,595 (tridhjetë e nente milion e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e nentëdhjetë e pesë) Lek pa TVSH,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Totali i pikëve të marra: Nuk aplikohet.

- 2- Operatori Ekonomik "M U R A T I" Shpk, me Nuis J66702413V, me oferte ekonomike 39,880,430 (tridhjetë e nente milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë leke) Lek pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Totali i pikëve të marra: Nuk aplikohet.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni prane Bashkise Lezhe brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (Nr.____ Datë____ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYETARI

Pjerin NDREU